



Informacione plotësuese mbi fletëpalosjen e Ndhmës për Banim Winterthur (Shërbimet e këshillimit, ndërmjetësimit, qiradhënies)

Kushtet tona

Ju banoni qe së paku 6 muaj në Winterthur. Raportet e Juaja financiare janë të sqaruara.

Çka presim prej Jush

Është e rëndësishme që Ju t'ju përmbaheni marrëveshjeve të bëra me ne. Këtu bëjnë pjesë fjala vjen:

- Ju na i sillni dokumentet që na duhen
- Ju ju përmbaheni termineve të bëra
- Ju angazhoheni aktivisht për banesë në tregun e lirë të banimit
- Ju na informoni në rast se situata Juaj ndryshon
- Ju jeni i pajtimit me atë që ne të marrim informacione edhe tek zyrat e tjera

Obligimi i heshtjes

Si nëpunës/e të Ndhmës për Banim ne i jemi të nënshtruar/a obligimit të heshtjes.

Çka ju ofrojmë ne

Këshillim në rast të kontratës së shfuqizuar të qirasë

Ne i këshillojmë individët apo familjet, kontrata e qirasë së të cilëve është shfuqizuar nga ana e qiramarrësit. Në bisedë personale sqarojmë arsyet e shfuqizimit të kontratës. Në marrëveshje me Ju ne marrim kontakt me qiramarrësin apo me zyrat e tjera dhe përpiqemi ta vendosim sërish kontratën e banimit. Në rast se qiramarrësi nuk heq dorë nga shfuqizimi i kontratës, ne ju përkrahim në ndërmarrjen e hapave ligjorë (si p.sh. kundërshtimi i fletëlargimit nga banesa, kërkesa për zgjatjen e afatit etj.).

Në rast se familjet edhe përkundër kërkesës intenzive nuk gjejnë zgjidhje përpiqemi t'ju organizojmë hapësirë të përkohshme banimi. Hapësira e banimit caktohet nga ne. Nuk ka mundësi zgjedhjeje. Në rast se refuzohet oferta, ne nga ana jonë e përmbylim këshillimin.

Personat pa familje mund të kalojnë natën në shtëpinë tranzit të „Heilsarmee“.

Këshillimi në rast të ekzistimit të kontratës së banimit

Në rast se kontrata e banimit nuk është e shfuqizuar ne ofrojmë një këshillim të shkurtë. Pikërisht e një këshillimi të tillë është si mund të kërkohet banesë më së miri.

Çka.